

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vende pune për personel akademik me kohë të plotë pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike në Departamentin e Inxhinierisë Kimike si më poshtë:

A. Kandidatët për personel akademik në pranë Departamentit të Inxhinierisë Kimike në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

- Të ketë mbaruar studimet e plota universitare (diplomë e integruar ose ciklet 3+2), brenda ose jashtë vendit, në degët e kimisë, me përparësi në Inxhinieri Kimike ose Kimi Industriale.
- Të ketë notë mesatare të përgjithshme mbi 8, ndërsa nota mesatare e lëndëve të kimisë të jetë mbi 8.5.
- Preferohet të ketë të paktën 2 vjet përvojë në mësimdhënie dhe në punën në laborator.
- Preferohen kandidatët që kanë tituj dhe grada shkencore.

Kandidati do të angazhohet kryesisht për programin/programet e studimit në Inxhinieri Kimike dhe, në veçanti, për lëndët:

1. Llogaritjet në Inxhinieri Kimike;
2. Reaktorët Kimikë.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MA);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **18.09.2026** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.